



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 25 Datë 13. 08. 2015

PËR

“NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.28, DATË 23.12.2014, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2015-2017 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2015” NË ZBATIM TË REFORMËS SË RE ADMINISTRATIVE- TERRITORIALE”.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 19 pika 9, nenit 32 gërma “dh” dhe nenit 39 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 39 dhe nenit 44 paragrafi i dytë shkronja “a” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); të Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri“, udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”(i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); të shkresës me nr.prot 11162/2 datë 03.08.2015 të Ministrisë së Financave mbi zbatimin e VKM nr.664 datë 29.07.2015, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë një shtesë në pikat 1.1 dhe 1.2 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”, në shumën totale **1,290,539,939 lekë** të përbërë nga:
 - a- **Fondi i mbartur nga Komunitat dhe Njësitë Bashkiake për vitin 2015**, sipas të dhënave dhe akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës në shumën 922,974,211 lekë.
 - b- **Shtesa në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2015** në shumën 92,072,600 lekë.
 - c- **Shtesa nga të ardhurat e komunave për 6 mujorin e dytë të vitit 2015** në shumën 275,493,128 lekë sipas pasqyrës nr. 1.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në zbatim të pikës 1 të miratojës detajimin e shumës totale të fondeve sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojës një ndryshim në numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës në pikën 2.2 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”, sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojës shtesën e dy zv.Kryetarëve në strukturën e Aparatit të Bashkisë së Tiranës.
5. Të miratojës rishpërndarjen dhe detajimin e fondeve të planifikuara në buxhetin e Bashkisë së Tiranës nga Njësitë Bashkiake në Aparatin e Bashkisë për Programin e Arsimit dhe të Administratës Vendore sipas pasqyrës nr.1.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, të kryejë ndryshimet në buxhetin e vitit 2015 sipas pikave 1, 2, 3,5 të këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI